



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 272, Datë 10.12.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 179, DATË 08.11.2017,
“MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT
NATYROR” ALBGAS SH.A.” , I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 53, pika 2; dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 634/5 prot., datë 05.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAS sh.a ”, i ndryshuar;

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 02.04.2024, ka vendosur të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, duke i lënë kushtin shoqërisë “ALBGAS” sh.a. të depozitojë në ERE brenda datës 31.12.2024 realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10 e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- ERE njoftoi shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin nr. 59/2024 me shkresën nr. 634/2 prot., më datë 11.04.2024, për shtyrjen e afatit për realizimin e ndryshimeve ligjore deri më datë 31.12.2024.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 634/4 prot., datë 20.11.2024, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit të certifikimit si “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”. Shoqëria ka bërë me dije se vijon punën për zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, një proces ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rol kyç si institucioni përgjegjës për politikat dhe mbikëqyrjen e projekteve të zhvillimit. Gjithashtu, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka njoftuar se më 12 nëntor 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompania shtetërore e naftës SOCAR kanë nënshkruar një

memorandum bashkëpunimi për gazifikimin e qytetit të Korçës, i cili hap rrugën për fillimin e projektit të detajuar inxhinierik pas përfundimit të studimit të fizibilitetit.

- Shoqëria ka bërë me dije se, për shkaqe jashtë vullnetit të saj, transferimi i kompetencave dhe depozitimi në ERE i dokumentacionit për ndryshimet në nenet 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, dhe kalimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) janë jashtë përgjegjësisë së saj. Shoqëria mbetet në pritje të një përgjigjeje përfundimtare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përmbushjen e këtij kushti.
- Duke u bazuar në sa më sipër dhe informacionin e bërë të ditur nga shoqëria, kushti mbetet ende i paplotësuar. Në këto rrethana, vlerësohet e arsyeshme të merret në konsideratë kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit për përmbushjen e këtij kushti deri më datë 31.12.2025, sipas sqarimeve të paraqitura prej saj.
- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 5.2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon:
5.2 Brenda datës 31.12.2025 shoqëria “ALBGAS” sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave.
2. Ky vendim i shtrin efektet menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI